

VENDIM
Nr.107, datë 15.2.2017

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.114, DATË 31.1.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KONTRIBUTEVE TË PERSONAVE QË VENDOSËN NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE PUBLIKE, TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3, të nenit 23, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.114, datë 31.1.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 3, të kreut I, bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë:
 - a) shkronja "b" ndryshohet si vijon:
"b) Fëmijëve të moshës 6-15 vjeç që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 1 000 (një mijë) lekë në muaj."
 - b) pas shkronjës "b" shtohet shkronja "b/1 me këtë përmbajtje:
"b/1) Fëmijëve të moshës 16-18 vjeç që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë në muaj."
 2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
 3. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama